

Zhvilloi punimet "Samiti i Grave të Biznesit"



Për herë të parë, gra të Diasporës shqiptare dhe vendase, të suksesshme në fushën e sipërmarrjes dhe biznesit, janë bërë bashkë në një kuvend të gjerë, organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Majko tha se ky aktivitet synon të jetë një platformë për fuqizimin e rolit të gruas shqiptare në shoqëri dhe në veçanti rritjen e angazhimit të saj në fushën e biznesit dhe sipërmarrjes si dhe nxitjen për krijimin e një rrjeti bashkëpunimi mes grave protagoniste brenda dhe jashtë vendit. "Takimi i sotëm është një pohim, jo vetëm ekonomik, por edhe për jetën sociale të shoqërisë sonë. Ai lidhet me faktin se gratë janë motori kryesor i ekonomisë shqiptare, si konsumatore, menaxhere dhe drejtuese. Organizimi i sotëm kërkon të nxisë trajtimin e cilësish së sipërmarrjes së grave në Diasporë", u shpreh ministri gjatë fjalës së tij. Më tej, ai u ndal edhe tek prezantimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës, e cila nisi punën e saj në muajin nëntor për të krijuar një frymë bashkëpunimi ekonomik mbarëshqiptar.

Në konferencën "The Central and Eastern European Forum 2020", Vjenë



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori pjesë në konferencën dyditore "The Central and Eastern European Forum 2020", e cila u zhvillua për të 25 vit radhazi në Vjenë të Austrisë. Fokusi i konferencës është perspektiva ekonomike e shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore në vitin 2020. Gjatë fjalës së tij në panelin "Albanians going international", ministri Majko u ndal tek roli i remitancave si burim i të ardhurave për vendet në zhvillim, përfshirë edhe Shqipërinë. "Remitancat në Shqipëri kanë ndikuar në përmirësimin e standardit të jetesës së familjeve, të cilat përfitojnë nga këto dërgesa. Ato janë burim i rëndësishëm i zhvillimit të vendit, ndaj sot sektori privat dhe publik në Shqipëri është përqëndruar në krijimin e një bashkëpunimi të ngushtë me anëtarët e Diasporës", është shprehur më tej ministri.

Publikohet revista elektronike e mbledhjes së parë të Këshillit Koordinues të Diasporës

Mbledhja e parë e Këshillit Koordinues të Diasporës

Tiranë, 18 Dhjetor 2019

Revista "Mbledhja e parë e Këshillit Koordinues të Diasporës" është një botim i veçantë elektronik që përmbledh të gjitha vendimet e miratuara gjatë mbledhjes së parë, zhvilluar më 18 dhjetor në Tiranë. Pjesë e kësaj reviste është edhe Rregullorja e Funkcionimit të Këshillit, e cila përcakton funksionimin e brendshëm, të drejtat dhe detyrat që ka secili anëtar. Këshilli Koordinues i Diasporës është një strukturë e re, në historinë e shtetit shqiptar dhe funksionimi i tij mbështetet në Ligjin Nr. 16/2018 "Për Diasporën".

Mbledhja e Këshillit Drejtues të FSHZHD- së. Kalohet për diskutim dhe miratim Raporti Vjetor për vitin 2019



U zhvillua mbledhja e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Gjatë mbledhjes u kalua për diskutim dhe miratim Raporti Vjetor për vitin 2019. Në mbledhje, u prezantuan projektet në zbatim dhe projekti i ri i Gazetës së Diasporës, platformat e ngritura, digjitalizimi i veprave të autorëve shqiptarë si dhe bashkëpunime të reja për 2020-tën.

Greqi / Komisioni parlamentar pro marrëveshjes për lejet shqiptare të drejtimit të automjeteve



Marrëveshja për njohjen e patentave shqiptare në Greqi pranohet nga komisioni parlamentar grek, pritet ratifikimi i saj në parlament. Komisioni i Përhershëm për Prodhim dhe Tregti në Parlamentin grek miratoi Projekt ligjin për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit midis Shqipërisë dhe Greqisë. Marrëveshja është firmosur në maj të vitit 2018, por pritet vetëm miratimi i saj nga parlamenti grek. Sipas kësaj marrëveshjeje, të gjithë shtetasit shqiptarë që zotërojnë leje drejtimi, model i lëshuar nga 1 korriku i vitit 2005, ose ata që janë të pajisur me formatin që ka nisur të shpërndahet nga 24 janari i vitit 2017, mund të drejtojnë automjetin e tyre edhe në territorin grek. Marrëveshja parashikon që në momentin që shtetasit shqiptarë marrin qëndrim në Greqi, ata mund t'i konvertojnë patentat e tyre shqiptare në patenta greke pa pasur nevojë kryerjen e testeve teorike dhe praktike. Konvertimi i patentave vlen edhe për shtetasit grekë që marrin qëndrim në Shqipëri.

Takimi i Mjekësisë në Diasporë

Agjencia Kombëtare e Diasporës fton profesionistë të fushës së mjekësisë që jetojnë jashtë Shqipërisë të marrin pjesë në Takimin e Mjekësisë në Diasporë, i cili do të organizohet më 20 shkurt në Tiranë. Takimi ka për qëllim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me Diasporën shqiptare, promovimin e vlerave të anëtarëve të saj në fushën e shëndetësisë si dhe nxitjen e bashkëpunimit mes mjekëve në Diasporë dhe mjekëve në Shqipëri. Për të marrë pjesë në këtë takim ose për informacione të mëtejshme, ju lutemi na kontaktoni në adresën: info@akd.gov.al




Qendra e Botimeve për Diasporën fton shkrimtarët, studiuesit, publicistët dhe dashamirët e letërsisë që jetojnë në Diasporë që të marrin pjesë në Takimin Mbarëkombëtar të Shkrimtarëve të Diasporës "Letra nga Diaspora" më 22 shkurt në Tiranë. Ky takim do të ndihmojë në njohjen, promovimin dhe krijimin e komunikimit të shkrimtarëve të Diasporës me lexuesit dhe botuesit shqiptarë dhe synon prezantimin e letërsisë së Diasporës, duke u këthyer në një traditë vjetore dhe në një zëdhënës të rëndësishëm të letërsisë së migracionit shqiptar. Për të marrë pjesë në këtë takim ose për informacione të mëtejshme, ju lutemi na kontaktoni në adresën: info@qbd.gov.al

Takimi i Mësuesve në Diasporë



Qendra e Botimeve për Diasporën fton mësuesit që jetojnë në Diasporë që të marrin pjesë në Takimin Mbarëkombëtar të Mësuesve nga Diaspora më 14 mars në Tiranë. Ky aktivitet do të ndihmojë në njohjen, promovimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve të Diasporës dhe vendit amë. Takimi synon diskutimin e procesit të mësimdhënies në Diasporë, ndërtimin e urave të qëndrueshme të komunikimit me mësuesit e Diasporës, si përcjellës të rëndësishëm të gjuhës, traditës dhe kulturës shqiptare të brezat e rinj që jetojnë në mërgatë. Për të marrë pjesë në këtë takim ose për informacione të mëtejshme, ju lutemi na kontaktoni në adresën: Fabola.Causaj@qbd.gov.al

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania".

KKD / Adriana Fishta Bejko: "Diaspora, një qelizë e ndarë në dy pjesë"



Sekretarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, Adriana Fishta Bejko në një intervistë televizive për televizionin shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjuhën shqipe, ka ndarë një pjesë të jetës së saj profesionale në Shqipëri dhe ka folur mbi aktivitetin e saj, si pjesëtare e komunitetit shqiptaro-kanadez. Bejko filloi karrierën si mësuese në moshën 22-vjeçare, pranë një shkolle në Peshkopi. Më pas ajo u këthye në Tiranë dhe punoi në gjimnazin "Qemal Stafa". Për arritjet e saj në fushën e arsimit në vitin 2002, ajo u vlerësua me çmimin "Who's Who" për kontinentin amerikan dhe çmimin e dytë për "Emigrant of Achievement", Calgary, Kanada. Në këtë intervistë, ndër të tjera ajo është shprehur se: "Diaspora, nga vetë kuptimi i fjalës dia që do të thotë dhe spora-qelizë, është një qelizë e ndarë në dy pjesë".

Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë

Takimi i Mësuesve në Diasporë